

LEDI SHAMKU-SHKRELI

CAMAJ – PARATHANËS I VENDFORMIMIT TË NEOSTANDARDIT

Kolegë, jemi mbledhë sot përreth Camajt, ndaj Martini s'mund të mungojë. E, më fort se kur flitet për atë vetë, ai duhet me qenë i pranishëm sa herë që flitet për Shqipen – gjuhë amtare e tija dhe jona. Kështu pra, meqë krye-verb i fjalës time sot është Shqipja, përmasa jonë etno-kulturore, ju grish të kthehemi 20 vjet mbrapa në kohë, në 2 dhjetor të 1991, në Seminarin e Salernos kushtuar shtresimeve të shqipes. Ky seminar u çel nga Camaj, pikërisht nga Camaj, dhe nuk është gand që Adolorata Landi dhe Patrizia del Puente zgjodhën atë për me hapë një seminar, i pari i një kohe kur besohej se fryma e lirisë dhe demokracisë do ta rimte sërish edhe pëlhurën tonë gjuhësore të ngrirë nga diktatura. Thashë pak parit se Camaj sot nuk mund të mungojë, ndaj le t'i ndëlgojmë kumtet e tij: *“Ka rreth njëzet vjet që në Shqipëri po vazhdon procesi i normalizimit të gjuhës, i cili nuk merr parasysh randësinë e dialekteve e të historisë, ase të dokumentave si: dorëshkrime, tekste letrare etj. Teoria themelore që drejtoi procesin e ndjekun për zbatimin e normës, që në të vërtetë është vënë në jetë me dhunë, i përket Stalinit. Hoxha (nuni i saj sipas Camajt) në vend të gjuhës, imponoi praktikisht dialektin e vet, ase më mirë, një prej nëndialekteve të tosknishtes lindore. Cdo variant tjetër gjuhsor letrar u ndalua, në veçanti ai i veriut. U pengue edhe zhvillimi i tosknishtes tradicionale letrare, në veçanti përbësja e saj perëndimore, që është zhvilluar në hapsinën prej bregut shqiptar të Jonit deri në Peloponez e prej aty bashkohet me zonat arbëreshe të Italisë jugore. Këtu është trashiguar një traditë letrare e zgjedhur e tanë sqimti, e ngjashme me klimen e butë mesdhetare”*.

Ngula këmbë që për punë të shqipes së përbashkët sot Camaj të shprehej vetë, ashtu shkipët e pa “dragomaj”, për t'ia shkëputë kumtet e tij cergave tjetërsuese, të cilat vijimisht e përmes manipulimesh, e kanë cilësuar si hiperlokalist, anti-unitar e anti-kombëtar. Porse Camaj është ndër të rrallët, për të mos thënë i vetmi që iu referohet gjithnjë tri koineve sa herë rrihet argumenti i normës. Ai dëshmon për këtë trini si *in varietate concordia*, apo për t'ia dhënë fjalën atij vetë: *“për gati një gjysë shekulli*

para ardhjes së stalinizmit, tre variantet letrare janë zhvillue lirshëm në një simbiozë harmonike. Weigand-i, Nahtigal-i, Pekmezi, Xhuvani e deri edhe autorë veriorë si Fishta e Gurakuqi, këshilluen që unjisi i gjuhës zyrtare të mbërrihej nepërmjet “avitjes” së këtyre varianteve. Kjo gjë duhej me u krye jo në mënyrë të vrazhdë. E në të vërtetë, deri në 1944 shoqëria shqiptare zhvillohej në një rreth simbiozet familjare, kulturore e gjuhsore. Në veçanti në Tiranë kryheshin kontaktet e para gjuhësore mes atyre që përdorin dialekte të ndryshme; aty kryhet afrimi. Treguesit e këtij afrimi ishte dashtë me u ndjekë me kujdes, duke gjetë rrugën më të drejtë për unjisinin e gjuhës”.

Në duam ta përmbledhim, kumti kryesor i citimit të mësipërm është se Camaj, njëzet vjet të shkuara, gjykonte se shqipja e përbashkët evolutive, do ta kish pasë epiqendrën e vet të formimit në truallin sociolinguistik të Tiranës kryeqytet. Natyrisht, mendonte Camaj, do ta kish pasë po të mos ja kish zënë vendin Shqipja Totalitare. Madje, shton gjuhëtari, në atë truall jo vetëm do të latohej entiteti gjuhësor prej miliona replikash kompromise nga çdo areal shqipfolës, por po në atë amë sociolinguistike duheshin zgjedhur edhe elementet rregullarizuese të induktuara (*Treguesit e këtij afrimi ishte dashtë me u ndjekë me kujdes, duke gjetë rrugën më të drejtë për unjisinin e gjuhës*). Nuk është i vetmi Camaj që e mendon kështu. Guiraud në vitet '70 shkruan: “*duhet shqyrtuar mirë ligjërimi popullor parizian, që sot në fakt është ligjërimi popullor i thuajse të gjithë francezëve, apo së paku i atyre që e përdorin frengjishten në mënyrë të natyrshme*”.


Çfarë ndodhi në fakt në këto 20 vjet? Për nga pikëpamja sociolinguistike gjithë këto kohë lëvizjesh të lira demografike, Tirana, në aspekt gjuhësor, nisi të shërbejë si truall pritës për nivelet dhe regjistrat e ndryshme gjuhësore që konvergojnë aty si ligjërime ardhëse. Saussure pohon se të gjitha gjuhët ardhëse do të ndryshojnë nën trysninë e sistemit gjuhësor pritës; por nuk është vetëm gjuha ardhëse ajo që ndryshon, pasi edhe idioma pritëse pëson ndikime nga përplasja me të parën. Kështu ndodh që trualli gjuhësor konservativ (i Tiranës) modifikon ligjërimet ardhëse, por njëkohësisht modifikohet prej tyre. Nga ky “proces alkimik” lind njëri ndër nivelet më të rëndësishme ligjërimore të shqipes së sotme, i cili në terma bashkëkohorë përkufizohet si *substandardi i metropolit*.

Por vini re, është shumë i rëndësishëm fakti që trualli gjuhësor pritës i Metropolit ja ka dalë ta ruajë karakterin konservativ. Për nga pikëpamja strukturore, ky fakt shpjegon edhe pse një pjesë e mirë e akomodimeve të sotme të shenjësve zyrtarë, akomodime të cilat kryhen prej këtyre forcave

vetëstrukturuese, ndjekin shpesh për inerci hullinë konservative. Ndaj duke i parë në çelës diakronik, shumica e përfatesave të sotme, ndonëse rezultojnë si inovacione në raport me normën, në raport me shqipen vetë dhe në thelb të tyre del se shpesh janë konservacione. Nga ana tjetër, prurjet e shumta e të shumëllojshme qoftë diatopike, qoftë diastratike që derdhen në substandardin e Metropolit, janë kryesisht të llojit inovativ. Fakti që këto inovacione përpunohen në një truall gjuhësor, substrati i të cilit, siç e kemi analizuar në punime të mëparshme, është me karakter konservativ, bën të mundur që neoformat e shqipes së sotme të mos jenë *mutacione* por *fraktale* të mëtejshme të së njëjtës lëndë historike. Me fjalë të tjera, duam apo nuk duam ne, substandardi i metropolit bëhet kështu njëri ndër garantët e evolucionit të pandërprerë të shqipes publike, i cili jo rrallë rezulton se po korrigjon edhe ndërhyrjet e djeshme subjektive në lëndë të shqipes. Ndodhemi përpara një situatë jo vetëm interesante nga pikëpamja gjuhësore, por edhe historike. Kjo “gjendje” duhet studiuar sa më shpejt, pikërisht se po të shqyrtohet dhe të përkrahet në kohë, do të shpjerë në forcimin dhe rivlerësimin mbi baza reale të kodit gjuhësor mbarëshqiptar. Gjithë kjo ngaqë sociolekti, me epërsinë e tij komunikuese, thyen te çdo idiomë atë që Saussure e quan *esprit de clocher* - mendësinë e izolimit - dhe vë kësisoj në lëvizje proceset e uniformizimit objektiv. Z. Ardian Vehbiu, lidhur me domosdoshmërinë e marrjes në konsideratë të këtij entiteti nga studiues dhe planifikues të shqipes shkruan se: “në të vërtetë, standardi ekzistues i shqipes e ka potencialin për t’u rishikuar pa çuar kjo në ndonjë shkoqe të identitetit gjuhësor dhe kulturor të shqipfolësve; por se çfarë do të rishikohet pikërisht, dhe si do të realizohet kjo, varet në masë të madhe nga çfarë është adoptuar prej folësve vetë përtej llogoreve dialektore, në atë “rain forest” të biomasës së shqipes së sotme, që është Tirana.

Me fjalë të tjera substandardi i metropolit mund të konsiderohet si “gjuhë në kontakt”, që farkohet në rastin tonë ndërmjet dialekteve dhe shqipes standarde të të gjitha stileve, ndaj dhe paraqet një fond të pasur gjuhësor. Veç të tjerash, është edhe një vënie në provë e gramatikës, duke qenë se bazohet mbi mekanizma pragmatike që priren ta thjeshtojnë sistemin e kodit formal parashkrues. Saussure dëfton se “ai që e krijon gramatikën, e ka në dorë sa kohë s’e ka hedhur në qarkullim; por që nga çasti kur ajo përmbush misionin e saj duke u bërë pronë e gjithkujt, kontrolli del dore. Sikur njeriu të pretendonte se po krijonte një gjuhë të pandryshueshme, të cilën pasardhësit duhet ta pranonin të pacënuar, ai do t’i ngjasonte një pule që kllonit vezë rose: gjuha e krijuar prej tij, me hir a me pahir, do të përfshihej në rrjedhën që merr me vete të gjitha gjuhët”.

Gjallimi i substandardit të metropolit është një tjetër element prove në mbështetje të tezës se shqipja, si çdo gjuhë tjetër, zhvillohet përmes një *continuum*-i gradual evolutiv duke kaluar në këto etapa:



Këtë do të ketë pasur në mend edhe Camaj njëzet vjet të shkuara, kur tërhoqi vëmendjen tek rëndësia parake e asaj “përziemje të vetvetishme që ka ndodhë e ndodh prorre në Tiranë”. Kjo prurje substandarde popullore, e cila mungon krejt në kodin standard, vijon të ushqejë përditë proceset ristandardizuese të shqipes. Dhe prania e substandardit është në të vërtetë prani e folësit e madje e një folësi kolektiv transhendent, i cili është bartës i shqipes që ka qenë, por dhe i asaj që do të jetë. Gjithë këtë trashëgimi kodesh stilesh e regjistrash, të shkruar e sidomos të folur, tok me tharmin unitar të ardhmënisë, substandardi e ofron pareshtur e përmes procesesh mirëfilli vetërregulluese, në ristandardizimin e shqipes letrare. Dhe në fakt matjet e kanë dëshmuar tashmë se ka lindur e po fuqizohet **varieteti Neostandard si formë e thjeshtuar dhe e pasuruar e Standardit, që ka përdorim masiv dhe që gjuhësisht e kulturalisht paraqitet më i hapur se Standardi**, pasi mund të përmbushë të gjitha nevojat e komunikimit publik, deri edhe ato praktike e të përditshme. Neostandardi gjendet në kapërcyell të gjuhës së shkruar e asaj të folur. Përbërësit e këtij varieteti del se janë: Substandardi i Metropolit + Tiparet e Gjuhës së Shkrimit. Ky rezultat është mirëfilli pohim i parathanës së Camajt: vendformimi i Neostandardit të Shqipes është Tirana Metropol. Po ashtu matjet dëftojnë se ky Neostandard po realizohet në plotninë e vet diamezike, pra si në rrafsh të folur, ashtu edhe në rrafsh të shkruar.

Neostandardi i shkruar është ai varietet i shqipes së përbashkët, me të cilin po identifikohen gjithnjë më shumë përdoruesit e shqipes, duke filluar nga përdorimi i saj si gjuhë publike e deri te përdorimet vetjake nga nxënës, studentë apo shkruar të mesëm. Epërsia e këtij varieteti ndaj normës standarde qëndron pikërisht në dy tiparet karakteristike të tij:

- në praktikitetin e repertorit të tij gjuhësor, me të cilin mund të përmbushet një gamë mjaft më të madhe situatash shkrimore, pra jo vetëm situatat thellësisht formale;

- në afërinë që ngërthen ky varietet me përdorimet e folura dhe me formate trashëguara të traditës.

Neostandardi i folur është varieteti i Shqipes së Sotme drejt të cilit synojnë gjithë ata përdorues që, duke zgjedhur ta përvetësojnë në të folurën e tyre prestigjin që ofron gjuha letrare, e deskematizojnë dhe e ristandardizojnë vijimisht këtë të fundit në përputhje me kushtet e reja social-kulturore. Natyrisht që Neostandardi i Shqipes së Sotme ka edhe një gjurmë të ndjeshme të *pragmatizmit gjuhësor*, prej të cilit në mjaft situata ai paraqitet edhe si i varfër në mjete, por kjo çështje i takon më shumë kulturës së gjuhës sesa gjuhës vetë. Dhe si e tillë mund të përballet duke i kundërvënë mes të tjerash një edukim gjuhësor demokratik, i cili nxit qarkullimin e mjeteve shprehëse, të atyre mjeteve të simbiozës “së trashëgueme” – siç e quan Camaj, duke pasuruar kësodore kompetencën e mandej performancën e shqipfolësve.

Kolegë, këtu e 20 vjet më parë Martin Camaj përfytyroi ringjalljen e unitarizmit gjuhësor në shqipen që pat shkizmuar ideologjia. Parathana e tij shenjoj Tiranën e çliruar si vatër të unitarizmit gjuhësor. Njëzet vjet më pas, koha po i jep të drejtë vegimeve poetike e andrrimtare të atij që rrëfeu se: “ngjarjet qi i kanë ra për hise gjuhës time qenë edhe shkaku më i thellë qi më ka shtye me u marrë si shkencëtar me gjuhën”. Kjo që po ndodh në Tiranë është vetëm fillimi i një reforme nga poshtë mbi shqipen.

